VENDIM
Nr. 112, datë 22.09.2015

PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË "STRELCA ENERGY" SHPK NË AKTIVITETIN E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HEC-et "STRELCA 1" ME FUQI TË INSTALUAR 1504 KW, "STRELCA 2" ME FUQI TË INSTALUAR 325 KW DHE "STRELCA 3", ME FUQI TË INSTALUAR 3520 KW (ME FUQI TOTALE TË INSTALUAR 5349 KW)

Në mbështetje të neneve 16; 37, pika 2, germa "a" dhe 110, të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të neneve 4, pika 1, germa "a"; 5, pika 1 germa "a"; 10 pika 3 të rregullores "Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/pjesshëm dhe rinovimit të licencave", të miratuar me vendimin e bordit të ERE-s, nr. 108, datë 9.9.2008 dhe nenit 18, pika 1, germa "a", e "Rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s", miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s, nr. 21, datë 18.3.2009, të ndryshuar, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 22.9.2015, pasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria "Strelca Energy" sh.p.k., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe të Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe të Mbrojtjes së Konsumatorit për licencimin në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike të kësaj shoqërie nga HEC-et "Strelca 1", "Strelca 2" dhe "Strelca 3",

konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë "Strelca Energy" sh.p.k. plotëson pjesërisht kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren "Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave", si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1) është plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni teknik-ekonomik (neni 9, pikat 4.1.4 dhe 4.1.5) është plotësuar në mënyrë korrekte.

Për mungesën e dokumentacionit, që ka të bëjë me:

- dokumentacionin juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2);
- dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3);
- dokumentacioni teknik- ekonomik (neni 9, pikat 4.1.1, 4.1.2, 4.1.3),

do të njoftohet subjekti që në bazë të rregullores "Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave", neni 10, pika 10 dhe neni 11, pika 1, t'i paraqesë këto në ERE, brenda afateve të përcaktuara.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurat për licensimin e shoqërisë "Strelca Energy" sh.p.k., në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC-et "Strelca 1" me fuqi të instaluar 1504 kW, "Strelca 2" me fuqi të instaluar 325 kW dhe "Strelca 3", me fuqi të instaluar 3520 kW (me fuqi totale të instaluar 5349 kW).
2. Drejtoria e Licencimit, Monitorimit të Tregut dhe të të Licencuarve të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-s
Petrit Ahmeti